



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:241879

Datë: 12.02.2024

Numri i dokumentit: 05314122

P.nr.1504/19

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm Penal-** gjyqtari Lulzim Hoxha, me bashkëpunëtoren profesionale Afërdita Kicaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit: L.B., nga Prizreni, lagjja “.....”, rruga “.....”, nr....., për shkak të veprës penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.7 lidhur me par.6 të KPRK-së, nr. 06/L-074, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.2094-9/19 të datës 14.11.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prizren Labinot Jetishi, të akuzuarit L.B., dhe mbrojtësit të tij Av.M.Sh., , me datë 05.02.2024, publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 12.02.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**L.B.**, nga i ati ....., e ëma ....., e lindur ....., i lindur me datën .....në Prizren, ku edhe banon, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i një fëmije, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikë së Kosovës, i identifikuar në bazë të numrit personal: .....

**ËSHTË FAJTOR**

Se me datën 09.09.2019, rreth orës 15:48:50min, në Prizren, saktësisht në rr. “.....”, i pandehuri derisa drejtonte automjetin e markës dhe tipit “.....”, me ngjyrë hiri dhe me targa të regjistrimit ....., vepron në kundërshtim me nenin 61 dhe 63 të ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, as sa vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, “atëherë kur shoferi i mjetit i cili hyn në rrugë me përparësi kalimi, është i obliguar t’u japë përparësi kalimi të gjithë mjeteve të cilat qarkullojnë në atë rrugë dhe kur shoferi i mjetit i afrohet kryqëzimit, ai duhet të lëvizë me kujdes të shtuar, në mënyrë që të i ‘u përshtatet kushteve të trafikut në kryqëzim dhe ta kuptoj mënyrën e rregullimit të trafikut në kryqëzim”, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari – i mituri N.A.,– ngasës i motoçikletës të markës dhe tipit “.....”, me ngjyrë të kaltër dhe me targa të regjistrimit ....., ishte duke qarkulluar në kryesore me përparësi kalimi, për një moment i pandehuri del në rrugën kryesore dhe i dëmtuari në pamundësi që të ndalet dhe ta evitoh aksidentin goditet me automjetin e lartcekur, fillimisht e godet shtyllën prej druri dhe më pastaj motoçikleta i bartet dhe e godet këmbësoren – të dëmtuarën A.A., , me ç ‘rast përveç dëmeve materiale në automjete, lëndime

të rënda trupore pësojnë të dëmtuarit: N.A.; dhe A.A, lëndime këto të konstatuara nga eksperti mjeko – ligjor Dr.M.G., të dhënë me datë 12.10.2019 dhe 13.10.2019.

**Me këtë , ka kryer veprën penale: rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së nr. 06/L-074.**

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 4, 7, 8, 9,17, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 71,72, të KPRK-së, si dhe nenit 364 KPPRK-së,

Të akuzuarit i shqipton :

### **DËNIMIN ME KUSHT**

- Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.
- Në qoftë se i akuzuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim prej dy (2) apo më tepër vjet i njëjti do të revokohet.

Të dëmtuarit me adresë si në shkresat e lëndës për realizimi e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civilo-juridik.

OBLIGOHET i akuzuara L.B., që ti kompenzoj shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare, duke përfshirë të gjitha shpenzimet, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej njëzet (20) euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit rrugor shumën prej dyzet euro e tetëdhjetetë cent (40.88) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

- Urdhërohet Shërbimi Sprovues i Kosovës - dega në Prizren, që të bëjë mbikqyerjen e dënimit me kusht.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm Penal, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2094-9/19, e datës 14.11.2019, kundër të akuzuarit: L.B., nga Prizreni, lagjja “.....”, rruga “.....”, nr....., për shkak të veprës penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.7 lidhur me par.6 të KPRK-së, nr. 06/L-074.

Duke vepruar në këtë çështje penale, gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor më datë 05.02.2024, në të cilin i akuzuari pas udhëzimeve lidhur me të drejtat të cilat i takojnë sipas ligjit, pasi që i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, e ka pranuar fajësinë që i ngarkohet me aktakuzë.

Në shqyrtimin gjyqësor, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, në këtë aspekt konform dispozitave ligjore të nenit 322 të KPPRK-së, i

akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave dhe në kuptim të nenit 322. par. 4. të KPPRK-së ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

**Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi se:** qëndroj pranë aktakuzës PP/II.nr. 2094-9/19 të datës 14.11.2019, kundër të akuzuarit L.B., për shkak te veprave te larte cekura si ne aktakuzë dhe i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe dënoj sipas ligjit, duke u bazuar ne dispozitat e Kodit Penal, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin e sotme e pranon fajësinë për veprat penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri në mënyrë vullnetare për veprat penale të cilat i vihen ne barë.

**Mbrojtësi i të akuzuarit L.B., - av. M.Sh.,** në fjalën përfundimtare deklaroi: pas pranimi te fajësisë nga i mbrojturi im, si dhe duke ditur rrethanat se është për herë të parë si kryes i veprës penale, kërkojmë nga gjykata qe ti shqiptohet një dënim sa më i butë, se konsiderojmë se me një dënim të butë të arrihet qëllimi dhe fryma e ligjit.

—  
**I akuzuari L.B., në fjalën përfundimtare deklaroi se:** pajtohem ne tërësi me theksimet e të mbrojturit tim, tjetër nuk kam fare ç’ka të shtoj.

Gjykata në shqyrtim gjyqësor nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datën 09.09.2019, rreth orës 15:48:50min, në Prizren, saktësisht në rr. “.....”, i pandehuri derisa drejtonte automjetin e markës dhe tipit “.....”, me ngjyrë hiri dhe me targa të regjistrimit ....., vepron në kundërshtim me nenin 61 dhe 63 të ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, as sa vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, “atëherë kur shoferi i mjetit i cili hyn në rrugë me përparësi kalimi, është i obliguar t’u japë përparësi kalimi të gjithë mjeteve të cilat qarkullojnë në atë rrugë dhe kur shoferi i mjetit i afrohet kryqëzimit, ai duhet të lëvizë me kujdes të shtuar, në mënyrë që të i ‘u përshtatet kushteve të trafikut në kryqëzim dhe ta kuptoj mënyrën e rregullimit të trafikut në kryqëzim”, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari – i mituri N.A.,– ngasës i motoçikletës të markës dhe tipit “.....-5”, me ngjyrë të kaltër dhe me targa të regjistrimit ....., ishte duke qarkulluar në kryesore me përparësi kalimi, për një moment i pandehuri del në rrugën kryesore dhe i dëmtuari në pamundësi që të ndalet dhe ta evitoj aksidentin goditet me automjetin e lartcekur, fillimisht e godet shtyllën prej druri dhe më pastaj motoçikleta i bartet dhe e godet këmbësoren – të dëmtuarën A.A., , me ç ‘rast përveç dëmeve materiale në automjete, lëndime të rënda trupore pësojnë të dëmtuarit: N.A., dhe A.A., lëndime këto të konstatuara nga eksperti mjeko – ligjor Dr.M.G., , të dhënë me datë 12.10.2019 dhe 13.10.2019.

Me këtë , ka kryer veprën penale: rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së nr. 06/L-074.

Gjykata, gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë prej të akuzuarit, i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, andaj edhe

gjykata nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme sipas nenit 251 të KPPK-së.

Gjithashtu, në tërësi e ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Kësisoj, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 240 lidhur me neni 242, dhe se në veprimet e të akuzuarit L.B., nga Prizreni, lagjja “.....”, rruga “.....”, nr....., për shkak të veprës penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.7 lidhur me par.6 të KPRK-së, dhe për këtë gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe t’i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69, 70, 71.72 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për rastin e ndodhur, kërkim faljen dhe i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris veprime të tilla kundërligjore. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori për bazë, veprën penale të kryer, niveli i dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyrën e kryerjes së veprës penale, shkallën e lartë të dashjes, veprimi me përgjegjësi, ku i akuzuari me dashje nuk i ka respektuar rregullat e trafikut duke shkaktuar rrezikim e trafikut publik dhe duke i shkaktuar të dëmtuarve lëndime të rënda trupore, andaj gjykata ia shqiptoi dënimin me kusht, sepse konsideron se me këtë masë sanksionuese do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla kundërligjore

Gjykata vendimin e ka mbështetur duke u bazuar edhe në neni 38 i KPK-së i cili konsiston në *“parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcim detyrimin për respektimin e ligjit”*.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 para. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ( KPPK-së).
- Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil është marrë në pajtim me nenin 462 par. 1. dhe 2. të KPPK-së.
- Vendimi mbi kompensimin e viktimave të Krimit, gjykata e mori në kuptim të nenit 36 parag.3 pika 3.1 të Ligjit me numër 08/L-109. ku thuhet *“për veprën penale që gjykohet në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore shuma është prej njëzet (20) Euro”*.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr. 1504/19, të datës 08.02.2024**

**B. Profesionale,**  
**Afërdita Kicaj**

**Gjyqtari,**  
**Lulzim Hoxha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga dita e pranimit të të njëjtit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet të kësaj gjykate.